



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Oraovac/Municipal Assembly Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3157 Më 27-11-2018  
Br. prot. 3157 Dt. 27-11-2018  
RAHOVEC - ORAHOVAC

## RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

Nëntor 2018

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 si dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së -Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 27.11.2018, miraton këtë:

## RREGULLORE MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

### I.DISPOZITAT THEMELORE

#### Neni 1 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme me përjashtim të kategorisë pronë publike brenda kufijve të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme.

### II.ZONAT TATIMORE

#### Neni 2 Zonat tatimore

Për vitin 2019, zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për M<sup>2</sup> në Komunën e Rahovecit caktohen si vijon:

| Kategoria e Vlerës                           | Nivelet e vlerave për M2 |         |          |         |        |         |
|----------------------------------------------|--------------------------|---------|----------|---------|--------|---------|
|                                              | Zona I                   | Zona II | Zona III | Zona IV | Zona V | Zona VI |
| <b>1.Prona rezidenciale</b>                  |                          |         |          |         |        |         |
| 1.1 Shtëpi familjare                         | 220.00                   | 180.00  | 150.00   | 130.00  |        |         |
| 1.2.Apartament                               | 220.00                   | 220.00  |          |         |        |         |
| 1.3.Garazh për shfrytëzim privat             | 88.00                    | 72.00   | 60.00    | 52.00   |        |         |
| 1.4.Objekt tjetër rezidencial -pa përfunduar | 88.00                    | 72.00   | 60.00    | 52.00   |        |         |
| 1.5 Pronat e braktisura                      | 88.00                    | 72.00   | 60.00    | 52.00   |        |         |
| <b>2.Prona Komercale</b>                     |                          |         |          |         |        |         |
| 2.1.Shitore                                  | 440.00                   | 440.00  | 360.00   | 300.00  |        |         |
| 2.2.Zyre                                     | 440.00                   | 440.00  | 360.00   | 300.00  |        |         |
| 2.3.Restorant                                | 440.00                   | 440.00  | 360.00   | 300.00  |        |         |

|                                            |               |                |                 |                |               |                |
|--------------------------------------------|---------------|----------------|-----------------|----------------|---------------|----------------|
| 2.4.Hotek                                  | 440.00        | 440.00         | 360.00          | 300.00         |               |                |
| 2.5.Objekt për magazinim komercial         | 440.00        | 440.00         | 360.00          | 300.00         |               |                |
| 2.6.Garazh komercial                       | 440.00        | 440.00         | 360.00          | 300.00         |               |                |
| 2.7.Pishine për shfrytëzim komercial       | 90.00         | -              | -               | -              |               |                |
| 2.8.Fushe e hapur sportive                 | 90.00         | -              | -               | -              |               |                |
| 2.9.Fushe e mbyllur sportive               | 90.00         | -              | -               | -              |               |                |
| 2.10.Pompe për derivate nafte              | 440.00        | 400.00         | 360.00          | 300.00         |               |                |
| 2.11.Objekt tjetër komercial               | 440.00        | 400.00         | 360.00          | 300.00         |               |                |
| <b>3.Pronë industriale</b>                 |               |                |                 |                |               |                |
| 3.1.Fabrikë                                | 300.00        | 280.00         | 250.00          | 200.00         |               |                |
| 3.2.Punishte                               | 300.00        | 280.00         | 250.00          | 200.00         |               |                |
| 3.3.Objekte për magazinim industrial       | 300.00        | 280.00         | 250.00          | 200.00         |               |                |
| 3.4.Objekte tjetër industrial              | 300.00        | 280.00         | 250.00          | 200.00         |               |                |
| <b>4.Njësitë rezidenciale të parcelave</b> |               |                |                 |                |               |                |
| ZONAT TATIMORE                             | <b>Zona I</b> | <b>Zona II</b> | <b>Zona III</b> | <b>Zona IV</b> | <b>Zona V</b> | <b>Zona VI</b> |
| Parcelë për shtëpi familjare               | 55.00         | 40.00          | 20.00           | 12.00          | 38.00         | 15.00          |
| Për ndërtesa apartamentesh                 | 55.00         | 40.00          | 20.00           | 12.00          | 38.00         | 15.00          |
| Për objekt tjetër rezidencial              | 55.00         | 40.00          | 20.00           | 12.00          | 38.00         | 15.00          |
| <b>5.Njësitë komerciale të parcelave</b>   |               |                |                 |                |               |                |
| ZONAT TATIMORE                             | <b>Zona I</b> | <b>Zona II</b> | <b>Zona III</b> | <b>Zona IV</b> | <b>Zona V</b> | <b>Zona VI</b> |
| Parcelë për objekte komerciale             | 100.00        | 75.00          | 65.00           | 36.00          | 55.00         | 28.00          |
| Parcelë për rekreacion komercial           | 100.00        | 75.00          | 65.00           | 36.00          | 55.00         | 28.00          |
| Parcelë për transport komercial            | 100.00        | 75.00          | 65.00           | 36.00          | 55.00         | 28.00          |
| <b>6.Njësitë industriale të parcelave</b>  |               |                |                 |                |               |                |
| ZONAT TATIMORE                             | <b>Zona I</b> | <b>Zona II</b> | <b>Zona III</b> | <b>Zona IV</b> | <b>Zona V</b> | <b>Zona VI</b> |
| Parcelë për industri                       | 34.00         | 22.00          | 20.00           | 8.00           |               |                |
| Parcelë për impiant elektrik               | 34.00         | 22.00          | 20.00           | 8.00           |               |                |
| Gropa zhavorri                             | 34.00         | 22.00          | 20.00           | 8.00           |               |                |

| 7.Njësitië objekteve bujqësore |        |         |          |         |        |         |
|--------------------------------|--------|---------|----------|---------|--------|---------|
| ZONAT TATIMORE                 | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV | Zona V | Zona VI |
| Arë                            | 5.00   | 1.50    | 3.00     | 2.20    | 3.80   |         |
| Kullosë                        | 3.40   | 1.00    | 2.10     | 1.50    | 2.60   |         |
| Livadh                         | 4.00   | 1.20    | 2.40     | 1.70    | 3.00   |         |
| Pemishte                       | 5.00   | 1.50    | 3.00     | 2.20    | 3.80   |         |
| Vreshta                        | 5.00   | 1.50    | 3.00     | 2.20    | 3.80   |         |
| 8.Njësitië pyjore të parcelave |        |         |          |         |        |         |
| ZONAT TATIMORE                 | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV | Zona V | Zona VI |
| Parcelë pyjore                 | 1.50   | 1.0     | 0.8      | 1.20    |        |         |
| Parcelë pyjore-malore          | 0.15   | 0.10    | 0.10     | 0.10    |        |         |

#### 9.Objekte Bujqësore

| ZONAT TATIMORE                     | Zona I | Zona II | Zona III | Zona IV | Zona V | Zona VI |
|------------------------------------|--------|---------|----------|---------|--------|---------|
| Objekt bujqësor për gjënë e gjallë | 95.00  | 70.00   | 80.00    | 80.00   | 95.00  |         |
| Ahur/Kotec                         | 70.00  | 55.00   | 60.00    | 60.00   | 70.00  |         |
| Hurdhë peshqesh                    | 110.00 | 90.00   | 100.00   | 100.00  | 110.00 |         |
| Objekt vjetër bujqësor             | 70.00  | 55.00   | 60.00    | 60.00   | 70.00  |         |

Në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Pronën e Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në Pronë ka nxjerrë raportin e përgjithshëm për këto kategori pronash .Njësitië pyjore të parcelave ,Njësitië Objektet bujqësor ,Njësitië bujqësore të parcelave, Njësitië industriale të parcelave,Njësitië komerciale të parcelave, Njësitië rezidenciale të parcelave.

**Neni 3**  
**Zonat dhe Nën zonat tatimore**  
**- Zona e I-rë**

Në bazë të karakteristikave dhe kriterëve mbi vlerësimin e bazës tatimore në këtë zone përfshihen:

a) Nga jugu i qytetit të Rahovecit-pompa e derivateve “Haxhijaha”, rruga e (UÇK –së, Rrethi ne hyrje te Rahovecit),vazhdon nëpër rrugën, Xhelal Hajda-Toni (deri tek qendra e qytetit),rruga Sheh Mehdini (deri tek Varrezat - Verije),dhe mbaron ne rrugën Xhevat e Alajdin Elshani deri te mulliri elektrik për përpunimin e drithërave.

b) Po ashtu në të njëjtën zonë përfshihen edhe territori:

Nga udhëkryqi (semaforët),sh.f.”Isa Boletini “nëpër rrugën Avdullah Bugari, deri shtëpia e Xhemajli Hamza, vazhdon rrugës Mezahir Isma (shtëpia e Muharem Ismes-udhëkryqit në hyrje te qytetit), nga vija rrugore gjer në 40 m.

c) Në të njëjtën zone do të përfshihej:

Nga udhëkryqi në hyrje të Rahovecit vazhdon në rrugën e Shkodranit transit gjerë te kufirin administrative të komunës se Rahovecit nga vija rrugore gjer në 40 m nga të dy anët.

d) Fillon prej Urës së Fshenjtë nëpër magjistrale Gjakovë – Prizren gjerë te kufiri administrativ Krushës së Madhe nga vija rrugore gjer në 40 m. nga të dy anët.

e) Nga udhëkryqi i Xërxës nëpër rrugën magjistrale Xërxë-Rahovec gjerë te pompa e derivateve “Haxhijaha” nga vija rrugore gjer në 40 m. nga të dy anët.

**Zona e II-të**

Edhe kjo zone është e përfshirë në bazë të karakteristikave të cekura më lartë.

a) Në këtë zonë përfshihet pjesa e mbetur e qytetit të Rahovecit nga zona e pare Xërxa, Fortesa, Celina deri te objekti i shkollës fillore Faik Konica

b) Rruga regjionale Gradish – Kramovik me këto vendbanime: Gexhe, Malësi e Vogël, Ratkoc, Denj, Dabidol, Çifllak dhe Kramoviku.

c) Rruga prej Mullirit elektrik Rahovec- Brestoc- Krusha e Madhe, në këtë zone përfshihen këto vendbanime: Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc.

d) Nga varrezat shqiptare të qytetit në rrugën regjionale Rahovec-Apterush - Therand, gjer në kufirin administrative të komunës së Rahovecit respektivisht përfshihen këto vendbanime: Hoçë e Madhe, nga vija rrugore gjer në 40 m nga të dyja anët.

**Zona e III-të:**

Edhe kjo zone i ka karakteristikat e veta në bazë të cilave është bërë përfshirja e këtyre vendbanimeve

a) Sopniq, Patoqan i Ulët, Patoqan Epërm, Nashpall, Drenoc, Senovc, Pastasell, Vranjak, Bratatin, Reti dhe Reti e Ulët dhe Palluzhë

**-Zona e IV-të:**

Në këtë zone përfshihen të gjitha vendbanimet e Komunës së Rahovecit të cilat nuk janë përfshirë në zonat e cekura më lartë, respektivisht vendbanimet malore, e këto janë:

a ) Zatriq , Kaznik ,Guri i Kuq dhe Mrasor

**Neni 4**  
**Normat Tatimore**

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Rahovecit; cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

| Kategoria e Pronës                    | Norma tatimore |
|---------------------------------------|----------------|
| Për njësitë bujqësore të parcelave    | 0.16 %         |
| Për njësitë bujqësore të objekteve    | 0.16 %         |
| Për njësitë pyjore të parcelave       | 0.16 %         |
| Për njësitë rezidenciale të parcelave | 0.16 %         |
| Për njësitë rezidenciale të objekteve | 0.16 %         |
| Për njësitë komerciale të parcelave   | 0.17 %         |
| Për njësitë komerciale të objekteve   | 0.17%          |
| Për njësitë industriale të parcelave  | 0.16%          |
| Për njësitë industriale të objekteve  | 0.16 %         |

#### Neni 5 Shfuqizimi

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren Nr. 01 NR.2621 datë 30.08.2017

#### Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2019.

#### Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim - Rregullore është e bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 si dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit.

Nga të cekurat propozohet miratimi i kësaj Rregulloreje.

*Rregullorja i dorëzohet:*

1. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
2. Ministrisë për Financa
3. Sektorit të Tatimit në Pronë
4. Arkivit komunal

**01 Nr. 3157**  
**Rahovec, 27.11.2018**

